



Nr. 88/ Prot
10

Tiranë 10/2 / 2026

URDHËR

Nr. 28, datë 10/2 2026

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT TË
KANDIDATËVE PËR KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË
POPULLIT**

Në zbatim të nenit 2 dhe 33/1, pika 4, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe nenit 8 të Rregullores "Për procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për Komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit", miratuar me urdhrin e brendshëm nr. 199, datë 10. 12. 2021,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës, që do të vlerësojë dhe shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët për Komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit.
2. Grupi i punës drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ka në përbërje:
 - Znj. Jona Boçari - Anëtar
 - Znj. Dorina Memetaj - Anëtar
 - Znj. Etrita Petriti - Anëtar
3. Detyra e grupit të punës do të jetë shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit në lidhje me plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatëve për Komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit si dhe përgatitja e një raporti i cili i njoftohet menjëherë Avokatit të Popullit.
4. I gjithë procesi i vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit nga grupi i punës do të realizohet duke respektuar të gjitha procedurat dhe rregullat e parashikuara në nenin 8 të Rregullores "Për procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për Komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit".
5. Ngarkohet specialisti i protokollit që t'u njoftojë anëtarëve të grupit të punës këtë Urdhër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



AVOKATI I POPULLIT

Endrit SHABANI

Endrit Shabani